



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**

**RREGULLORE**

**MBI  
TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA  
DHE/APO PALËT QË I PËRKASIN TË NJËJTIT GRUP FINANCIAR**

*Miratuar me Vendimin e Bordit nr. 57, datë 29.03.2018*

**Neni 1**

**Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është vendosja e rregullave për transaksionet e portofolit të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, të kryera me palë të lidhura dhe/apo palët që i përkasin të njëjtit grup financiar, në emër ose drejtpërdrejtë me subjektet e përcaktuara si palë e lidhur me shoqërinë e administrimit të SIK, si dhe me depozitarin e fondit të investimit ose sipërmarrjen e investimeve kolektive.

Subjekt i kësaj rregulloreje është edhe çdo palë e lidhur dhe/apo palë që i përket të njëjtit grup financiar, e cila është përfshirë në transaksionet financiare me shoqëritë administruese të SIK.

**Neni 2**

**Fusha e zbatimit**

Kjo rregullore zbatohet nga subjektet të licencuara dhe të mbikëqyrura nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, për të ushtruar veprimtari si shoqëri administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe depozitari.

Kjo rregullore zbatohet edhe nga palët e lidhura dhe/apo palët që i përkasin të njëjtit grup financiar, të cilat veprojnë në funksionin e broker/dealer me shoqëritë administruese të SIK.

**Neni 3**

**Baza ligjore**

Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 2, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të nenit 46, pika 2 dhe

nenit 31 të Ligjit nr. 10 198, datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, i ndryshuar dhe Ligjit nr. 9789, datë 21.02.2008 “Për Titujt”.

Termat e përdorura në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim që i është dhënë atyre në ligj.

#### **Neni 4**

##### **Përkufizime**

Për efekt të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

**Palë të lidhura** - personat fizik ose juridik që janë të lidhur me shoqërinë administruese apo shoqërinë e investimit, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 10 198, datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, i ndryshuar.

**Palët që i përkasin të njëjtit grup financiar** - personi juridik i cili është pjesë e të njëjtit grup financiar me shoqërinë administruese.

**Transaksion “Arms Length”** - transaksioni ku blerësi dhe shitësi i instrumentit financiar veprojnë në mënyrë të pavarur dhe në interesin më të mirë vetjak, ashtu siç do kishin vepruar nëse do të bënin transaksion me një palë tjetër jo të lidhur, të kryer në përputhje me kushtet normale të tregut, ku nuk ka asnjë favorizim të padrejtë të fituar nga njëra palë në përfitim të palës tjetër.

#### **Neni 5**

##### **Transaksione me palë të lidhura dhe/apo palët që i përkasin të njëjtit grup financiar**

1. Shoqëria administruese mund të kryejë transaksione me palët e lidhura dhe/apo palët që i përkasin të njëjtit grup financiar të shoqërisë kur plotësohen kushtet e mëposhtme:
  - a. Transaksioni ka si objekt investimet e likuiditeteve të fondit të investimeve të kryera në një bursë ose treg të organizuar me kushtin që çmimi i transaksionit të jetë brenda kushteve të tregut sipas parimit “arms length” dhe palët e përfshira në transaksion të mos kenë rënë dakord në lidhje me çmimin përpara marrjes së vendimit për të kryer transaksionin.
  - b. Transaksionet që kanë si objekt shitjen e titujve të fondit të investimeve, me qëllimin e mbajtjes së treguesve të likuiditetit apo kërkesave të tjera rregullatore të kryera në një bursë apo treg të organizuar ose në një treg të rregulluar, me kushtin që çmimi i transaksionit të jetë brenda kushteve të tregut sipas parimit “arms length” dhe palët e përfshira në transaksion të mos kenë rënë dakord në lidhje me çmimin përpara marrjes së vendimit për të kryer transaksionin.
  - c. Transaksionet e titujve në një treg të rregulluar, me kushtin që çmimi i transaksionit të jetë brenda kushteve të tregut, sipas parimit “arms length” dhe në interesin më të mirë të investitorëve. Transaksioni duhet të kryhet nëpërmjet platformave Reuters ose Bloomberg ose mjeteve të tjera të komunikimit, dhe

- i. Transaksioni kryhet me një *broker/dealer* ndërkombëtar, i cili kuoton rregullisht në atë instrument, me çmime të ekzekutueshme;
    - ii. Transaksioni kryhet me një *broker/dealer* lokal, i cili kuoton rregullisht në atë instrument, me çmime të shfaqura rregullisht në faqen e tij të kuotimit dhe të ekzekutueshme.
  - d. Transaksionet të cilat kryhen në një treg të rregulluar të cilat nuk përfshihen tek shkronja “c”, e pikës 1, të këtij neni dhe të cilat deklarohen nga shoqëria administruese se janë kryer sipas parimit “arms length”, të mbështetur me dokumentacion.
  - e. Transaksionet të cilat kanë si objekt titujt ose instrumentat e tregut të parasë të emetuara nga organet e qeverisjes qendrore dhe vendore të Republikës së Shqipërisë të blera drejtpërdrejt në ankandin primar sipas kushteve më të mira të tregut.
  - f. Të gjitha transaksionet të cilat kanë si objekt titujt që emetohen për herë të parë me ofertë fillestare, te kryera sipas kushteve më të mira të tregut.
2. Transaksionet që përfshihen në shkronjën “e” dhe shkronjën “g” të pikës 1, të këtij neni konsiderohen “arms length”.
  3. Depozitari shqyrton dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Shoqëritë Administruese sipas Aneksit 2, dhe njofton në Autoritet nëse nuk është zbatuar parimi “arms length”.

## **Neni 6**

### **Vlerësimi**

Në rastet kur depozitari nuk është i sigurt për zbatimin e parimit “arms length”, njofton shoqërinë administruese dhe AMF-në.

Shoqëria administruese cakton një vlerësues të pavarur sipas kriterëve të nenit 7, të kësaj rregulloreje.

Shoqëria Administruese njofton Depozitarin dhe AMF-në për vlerësuesin e zgjedhur.

Pas përfundimit të vlerësimit, AMF ka të drejtë në çdo rast që e gjykon të arsyeshme ti kërkojë shoqërisë të ndryshojë vlerësuesin e pavarur.

## **Neni 7**

### **Kriteret e vlerësuesit të pavarur**

Vlerësuesi i pavarur duhet të ketë këto kriteret:

- a. Të jetë person juridik i pavarur nga shoqëria administruese, palët e lidhura me të dhe/apo palët që i përkasin të njëjtit grup financiar, administratori apo ekipi drejtues i të cilit nuk ka qenë drejtues i shoqërisë administruese, depozitarit, palët e lidhura me to dhe/apo palët që i përkasin të njëjtit grup financiar gjatë 10 viteve të fundit;
- b. Të mos ketë interesa financiare me shoqërinë administruese, aksionarët apo palët e lidhura me to;
- c. Të ketë eksperiencë në fushën e tregut të kapitaleve ose atë të vlerësimit financiar (të paktën 5 vjet eksperiencë);
- d. Të ketë integritet moral dhe etik dhe të mos jenë marrë masa nga ndonjë autoritet tjetër mbikëqyrës vendas apo i huaj për gjatë 5 viteve të fundit.

Plotësimi i kriterëve të mësipërme duhet të provohet me dokumentacionin përkatës.

## **Neni 8**

### **Ndalimi i praktikave abuzive**

Transaksionet me palët e lidhura dhe/apo palët që i përkasin të njëjtit grup financiar, të cilat kryhen për të rritur/ose ulur çmimin e kuotave të fondit, në mënyrë artificiale, me qëllim që të nxisin investitorët e tjerë, ose publikun e gjerë të blejnë ose të shesin kuotat janë të ndaluara. Këto transaksione do të trajtohen sipas nenit 98, dhe nenit 142 të Ligjit “Për Titujt”.

## **Neni 9**

### **Parandalimi i konfliktit të interesit**

Shoqëria administruese përcakton procedura dhe politika për adresimin e konfliktit të interesave që rrjedhin nga palët e lidhura dhe/apo palët që i përkasin të njëjtit grup financiar.

## **Neni 10**

### **Regjistrimi dhe mbajtja e të dhënave**

Të gjitha komunikimet me brokerat duhet të jenë të regjistruara.

Shoqëria administruese është e detyruar të mbajë të dhëna dhe dokumentacion për transaksionet me palët e lidhura deri në 7 (shtatë) vjet pas kryerjes së transaksionit.

Autoriteti ka të drejtën për të kërkuar në çdo kohë të gjitha të dhënat, regjistrimet e telefonatave dhe komunikimeve, printime të kuotimeve në momentin që është kryer transaksioni, për të verifikuar përputhshmërinë me këtë rregullore.

## **Neni 11**

### **Raportimi**

Shoqëria administruese raporton në Autoritet listën e transaksioneve me palë të lidhura dhe/apo palët që i përkasin të njëjtit grup financiar.

Raportimi duhet të përmbajë të gjitha transaksionet me palë të lidhura dhe personat e lidhur, që janë kryer gjatë tremujorit sipas rubrikave të përcaktuara në Aneksin 1, që i bashkëlidhet dhe është pjesë e kësaj rregulloreje.

Raporti duhet dorëzuar çdo tre muaj dhe brenda të njëjtit afat si edhe për raportimet e tjera tremujore dhe duhet të firmoset nga drejtori ekzekutiv dhe përgjegjësi i financës së shoqërisë së administrimit.

## **Neni 12**

### **Transparenca ndaj investitorëve**

Shoqëria administruese duhet të sigurohet që ka politika dhe procedura të mjaftueshme në lidhje me informimin e investitorëve për transaksionet me palët e lidhura dhe/apo palët që i përkasin të njëjtit grup financiar, kur këto transaksione kanë ndikim material mbi vlerën neto të aseteve.

## **Neni 13**

### **Shkeljet**

Në rast shkelje të dispozitave të kësaj rregullore Autoriteti ka të drejtën e marrjes së masave administrative të parashikuara në ligj.

## **Neni 14**

### **Hyrja në Fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi më 01.05.2018.

## ANEKS 1

<b>Pjesa A</b>	<b>Emri i asetit</b>	<b>Çmimi i paguar ose i marrë për letrën me vlerë</b>	<b>Çmimi i tregut për letrën me vlerë/ çmimi i referimit</b>	<b>Kostoja e transaksionit, si % ndaj e vlerës së transaksionit (komision, tarifa)</b>	<b>Vlera e transaksionit si % ndaj vlerës neto të aseteve në momentin e transaksionit/ve</b>	<b>Emri i kundërpalës dhe marrëdhënia me shoqërinë adminisruese ose shoqërinë e investimit</b>
Seksioni 5/1/a transaksione blerje						
Seksioni 5/1/b transaksione shitje						
Seksioni 5/1/c transaksione blerje						
Seksioni 5/1/c transaksione shitje						
Seksioni 5/1/d Transaksione blerje						
Seksioni 5/1/d transaksione shitje						
Seksioni 5/1/e transaksione blerje						
Seksioni 5/1/g Transaksione në blerje						

<b>Pjesa B</b>	<b>Vlera</b>				<b>Vlera në % e transaksioneve në total për periudhën raportuese</b>	<b>Lista e të gjitha kundërpalëve që zënë më shumë se 20% sipas vlerës së shitjeve dhe blerjeve</b>
Blerje në total nga palët e lidhura						
Shitje në total nga palët e lidhura						

## **ANEKS 2**

1. A është kryer transaksioni në bursë/treg të organizuar sipas kushteve të pikës 5/1/a?  
Nëse po, duhet konfirmimi i marrëveshjes të kryer në bursë.
2. Është kryer transaksioni në një treg të rregulluar sipas kushteve të pikës 5/1/b?  
Nëse po, dokumentacioni duhet të përfshijë:
  - a. Vendim nga shoqëria administruese për qëllimin e kryerjes së transaksionit;
  - b. Në rast të një tregu aktiv, një screenshot (p.sh. Bloomberg All quotes për letrën me vlerë e cila është tregtuar, verifikohet nëse çmimi ka qenë brenda “range bid/ask” të tregut, krahasohet dhe me “mid price”);
  - c. Në rast të një tregu të rregulluar por jo aktiv (kontaktet dhe bisedat e dokumentuara me të paktën tre broker/dealer ku është kërkuar ofertë për kryerjen e transaksionit “bid/ask”).
3. A është kryer transaksioni sipas kushteve të pikës 5/1/c?
  - Nëse është kryer me një broker/dealer ndërkombëtar, “screenshot” të të gjitha kuotimeve për atë instrument.
  - Nëse është kryer me një broker lokal, “print screen” të kuotimeve të brokerit në momentin e kryerjes së transaksionit, si dhe bisedat e dokumentuara me brokera të tjerë (krahasohet nëse çmimi ka deviacione nga “bid/ask range mesatar”).
4. A është kryer transaksioni në një treg të rregulluar por që nuk përfshihet në pikën 5/1/c?
  - Nëse po, deklaratën e shoqërisë administruese në lidhje me faktin që transaksioni ka qenë “arms length”, si dhe bisedat e dokumentuara me të paktën tre broker/dealera ku është marrë ofertë për kryerjen e transaksionit (bid-ask). Në qoftë se nuk ka oferta, duhet argumentim i detajuar nga shoqëria administruese, se përse konsiderohet “arms length” transaksioni, duke përfshirë kurbën e yieldit të instrumentit me interpolim, por duke eliminuar pikat e kurbës që kanë diferencë të dukshme me pikat e tjera.
5. A është kryer transaksioni sipas kushteve të pikës 5/1/g?  
Nëse po, dokumentacion mbështetës që vërteton se emetimi ka qenë për herë të parë.

